

AKT THEMELIMI
I
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“TravelHive Albania”

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, më 22.06.2022 (Njëzetë e Dy Qershor Dymijë e Njëzetë e Dy), ne, themeluesit, krijuam një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“TravelHive Albania” SH.P.K.**
- 1.2 Themelues të shoqërisë janë:
1. **Znj. Vojsava Suti**, e datëlindjes 24/08/1972, mbajtëse e Kartës së Identitetit me Nr. Personal **H25824051W**.
 2. **Znj. Eftychia-Andromachi Moutsou**, e datëlindjes 31/01/1992, mbajtëse e Kartës së Identitetit greke me Nr. **AB 415633**.
 3. **Z Andronikos Moutsos**, i datëlindjes 16/01/1988, mbajtës i Kartës së Identitetit greke me Nr. **AP 379897**.

Neni 2
Objekti

- 2.1 Objekti i aktivitetit të shoqërisë, pa u kufizuar në të, do të jetë:
“Aktivitete të ndryshme në fushën e turizmit”.

Neni 3
Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 99 vjet.

Neni 4:
Selia



4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: "Rruga 18 Shtatori, Ndërtesa 32, Hyrja 6, Apartamenti 11, kati i dytë, Gjirokastër"

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:
1. **Znj. Vojsava Suti**, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33.340 lekë që përben 33,34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. **Znj. Eftychia-Andromachi Moutsou**, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33.330 lekë që përben 33,33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 3. **Z Andronikos Moutsos**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33.330 lekë që përben 33,33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6 Administrimi

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

Të dhënat e identifikimit:

Znj. Vojsava Suti, e datëlindjes 24/08/1972, mbajtëse e Kartës së Identitetit me Nr. Personal **H25824051W**.

**Neni 7
Baza Ligjore**


- 7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8
Mosmarrëveshjet**

- 8.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente Shqiptare.

**ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"TravelHive Albania"**

Vojsava Suti




Eftychia - Andromachi
Moutsou



Andronikos Moutsos



Deklaroj se jam njohës i gjuhës Shqipe.



Deklaroj se jam njohës i gjuhës Shqipe.

